



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2022

VENDIM

Nr. 52, datë 08.02.2022

PËR

**PËRSËRITJEN E KOMANDIMIT TË GJYQTARES ZNJ. {...}
NË POZICIONIN E KËSHILLTARIT LIGJOR NË NJËSINË MBËSHTETËSE TË
KOMISIONEVE, NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61, 86, shkronja “d” dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 53, 54 dhe 57, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 315, datë 19.12.2019 “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, pasi shqyrtoi kërkesën e znj. {...}, protokolluar në Këshill me aktin nr. 191 prot., datë 14.01.2022, dhe aktin nr. 191/1 prot., datë 26.01.2022, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Përsëritjen e komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e “këshilltarit ligjor” në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për një afat dy vjeçar.
2. Efektet juridike të vendimit fillojnë më datë 10.02.2022.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR